



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0651**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga **Vjosa Gradinaj Mexhuani** duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Eor Group" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe montimi me tabela smart dhe Teknologji Informative sipas lot I dhe lot II” me numër të prokurimit VU644-23-7254-1-2-1, me 17/10/2023, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e OE "Eor Group" SH.P.K. me Nr.Protokolli 2023/0651, e datës 03/09/2023, kurse vendimi i AK KOMUNA E VUSHTRRIË lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe montimi me tabela smart dhe Teknologji Informative” me numër të prokurimit VU644-23-7254-1-2-1, për Lot I VERTETOHET ndërsa për Lot II anulohet dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Eor Group SH.P.K.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 19.07.2023, Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim dhe montimi me tabela smart dhe Teknologji Informative sipas lot I dhe lot II” me numër të prokurimit VU644-23-7254-1-2-1. Ndërsa me datën 14.08.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e

Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë Grupin e Operatoreve Ekonomik Infinit sh.p.k.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 44,007.00 €.

Me 18.08.2023, OE Eor Group SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 25.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.09.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Eor Group SH.P.K., me nr. 651/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim dhe montimi me tabela smart dhe Teknologji Informativ sipas lot I dhe lot II” me numër të prokurimit VU644-23-7254-1-2-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Eor Group SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

***Pretendimi*** Ankuesi pretendonse “ *Grupit të OE-ve të rekomanduar për kontratë i mungojnë deklaratat e qarta të grupit të OE-ve.* ”

***Pretendimi i dytë (II):*** Ankuesi pretendon se “*Grupit të OE-ve “Infinit sh.p.k. & ” KIGA sh.p.k i mungon katalogu dhe përshkrimi teknik për LOT 2 (Autoriteti Kontraktues a mundë të prezantoi vetëm një pajisje apo ndonjë pajisje për LOT 2 që ka dorëzuar OE katalog apo specifikim teknik për pajisjet e LOT 2, për këtë LOT 2 OE nuk ka dorëzuar asnjë katalog as një specifikim teknik të pajisjeve) prandaj bazuar në kërkesat e FTD të dosjes se tenderit me këtë rast duhet refuzuar tenderi i grupit të OE-ve “Infinit sh.p.k. & ” KIGA sh.p.k.*”

***Pretendimi i tretë (III):*** Ankuesi pretendon se “*Nga interpretimet e KRPP-së thuhet se kërkesat e shënuara në FTD të dosjes se tenderit janë obligative dhe duhet të përmbushen siç kërkohen në FTD të dosjes se tenderit nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë pretendim kur themi se CV nuk është e nënshkruar siç kërkohet në neni 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, me FTD është kërkuar: Dëshmia 2 - Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listës duhet të i bashkangjiten këto dëshmi si vijon: a) CV-a e nënshkruar në kopje, b) Diploma kopje, c) Kontrata apo parakontrata e punës ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt të nënshkruara nga punëmarrësi dhe Punëdhënësi si dhe të vulosura nga Punëdhënësi, të dorëzohet në kopje. Autoriteti Kontraktues në Vendim e datës 25.08.2023, thotë: se mungesa e nënshkrimit nuk paraqet devijim thelbësor, prandaj ky pretendim i Autoritetit Kontraktues nuk qëndron bazuar në Interpretimet e KRPP-së. Atëherë këto kërkesa sipas AK-së qenkan fontanë dëshirash, kur do Autoriteti Kontraktues i quanë thelbësore e kurdo Autoriteti Kontraktues thotë nuk janë thelbësore. Nga ky fakt themi se Autoriteti Kontraktues ka shkelë rendë neni 7 të LPP-së sepse kërkesën e vetë të dhëne me FTD të dosjes se tenderit e ka dhënë me qellim të dy*

*kuptimsi, kur i duhet të refuzoi tenderin e ndonjë OE për këtë arsye e refuzon e kur done thotë nuk është thelbësore për OE qe done ta favorizoj.*”

**Pretendimi i katërt (IV):** Ankuesi pretendon se “ *Grupi i OE-ve “Infinit “sh.p.k. & “KIGA “sh.p.k për LOT 1 kanë dorëzuar KATALOG, mirëpo të specifikacioni i smart board me touch me ekran led dhe softuer me materiale mësimore i ofruar me ofertë: GAOKE-Model E3, ka ndërhyrje në specifika teknike nga grupi i OE-ve “Infinit “sh.p.k. & “KIGA “sh.p.k duke i ndryshuar këto specifika teknike nga përmbajtja e prodhuesit dhe duke i harmonizuar me ato të Aneksi I Specifikat teknike të detyrueshme Specifikim teknik Lot I. Specifikat teknike qe I kanë ofruar Grupi I OE-ve “Infinit “sh.p.k. & “KIGA “sh.p.k për LOT 1 për pozicioni 1, te ndryshuara nga prodhuesi, faqja e dytë: Nëse I shikojmë specifikimet teknike në faqen zyrtare të prodhuesit këto specifikime teknike janë tjera Kur hapim specifikacionet teknike të web i prodhuesit e vërtetojmë se ndryshojnë me ato të prezantuara nga grupi i OE-ve “Infinit “sh.p.k. & “KIGA “sh.p.k dhe dyshojmë se me këtë rast ky grup i OE-ve kanë shkelur Deklaratën nën betim me ofrimin e të dhënave jot ë vërteta. Në vijim keni specifikat teknike sipas prodhuesit GAOKE Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ose është lajthitur nga grupi i OE-ve “Infinit “sh.p.k. & “KIGA “sh.p.k ose bazuar në përgjigjejen në letren standarde e ka favorizuar këtë grup të OE-ve.”*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE Eor Group SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28, 69 të LPP dhe shkeljet e dispozitave të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 08/09/2023 ka autorizuar ekspertet për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 651/23, ndërsa me datë 27/09/2023 është dorëzuar raporti i eksperteve me nr. 2023/0651 me rekomandimet si në vijim: “*eksperti shqyrtues dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, për Lot 1 të vërtetohet vendimi i AK-së, ndërsa për Lot 2 të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.*”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Eor Group SH.P.K., eksperti shqyrtues dhe teknik përmes raportit nr. 2023/0651 ka vlerësuar si në vijim:

**Pretendimi i parë (I) ankimor është i pa bazuar** pasi që “Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar deklaratë për themelimin e grupit e cilat është e dedikuar për këtë aktivitet të prokurimit dhe është e nënshkruar dhe vulosur nga dy anëtarët e grupit. Në deklaratë janë dhënë edhe tre pohimet që kërkohen sipas dosjes së tenderit, neni 11.1 Krijimi i një grupi te operatoreve ekonomik si dhe neni 26.1 të Rregullores për Prokurim Publik (RrPP). Eksperti shqyrtues dhe teknik sqaron se neni 26 i RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK ka përcaktuar: 26.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet te:a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; dhe d. Secili anëtar i grupit duhet të jetë i regjistruar në platformën elektronike, kërkesë e cila duhet të përcaktohet në dosje të tenderit.(Nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri në njoftim zyrtar nga KRPP); 26.2 Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument. Andaj bazuar në neni 26.2 të RrPP-së ku thuhet se Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument, rezultojnë se grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar deklaratën në pajtim me neni 26 të RrPP-së. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar. (Provë: Deklarata për Themelimin të Grupit dhe Deklaratat nën Betim).”

**Pretendimi i dytë (II) ankimor është i bazuar** pasi që “AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional ndër të tjera ka vendosur kërkesën: “Kërkesa 2- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se mallrat e ofruara përmbushin specifikimet teknike sipas Aneksit nr.1 të Dosjes së tenderit”. Për këtë kërkesë si dëshmi dokumentare e kërkuar është: “Dëshmitë 2 a) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë katalog apo broshurë me fotografi në të cilën në mënyrë të qartë specifikohen të dhënat për artikujt sipas specifikave teknike të dhëna në Aneksin 1.b) Deklarata me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik me të cilën dëshmohet se mallrat e ofruara përmbushin përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.” Në ofertën e dorëzuar nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë, është dorëzuar vetëm deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike, e cila është e nënshkruar dhe vulosur, ndërsa për pajisjet për Lot 2 nuk është dorëzuar katalogu si dëshmi për përmbushjen e kërkesës sipas pikës a). Andaj pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.”

**Pretendimi i tretë (III) ankimor është pjesërisht bazuar** pasi që “AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional ndër të tjera ka vendosur kërkesën Kërkesa 3. 2 OE-ik duhet të ofrojë dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon A) Një (1) bachelor ose inxhinier të shkencave të inxhinierisë me përvojë pune minimale prej 3 vite pas diplomimit. Për këtë kërkesë si dëshmi dokumentare AK ka kërkuar: Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listës duhet të i bashkangjiten këto dëshmi si vijon a) CV-a e nënshkruar në kopje. Në tenderin e dorëzuar nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë është dorëzuar CV e z.Nexhmedin Gërguri. Dokumenti i CV nuk është i

nënshkruar. Referuar vendimit të AK-së, datë 18.08.2023, rezulton se AK ka nxjerrë vendim për refuzimin e ankesës së OE ankues, me arsyetimin si vijon: “[...] Lidhur me pretendimin nr.3, AK konfirmon se OE e shpërblyer ka përmbushur këtë kriter, sepse mungesa e nënshkrimit nuk paraqet devijim thelbësor, prandaj ky pretendim nuk qëndron. Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar CV si dëshmi dokumentare për plotësimin e kërkesës me informatat për personin e propozuar si inxhinier. Fakti që dokumenti nuk është i nënshkruar nuk mund të pretendohet se nuk plotësohet si kërkesë dhe konform nenit 59, paragrafi 4, pika (ii) mos nënshkrimi i CV konsiderojmë që është devijim i vogël që nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, ku këtë konstatim e bazojnë edhe në faktin se i njëjtit ka marrëveshje për angazhim për këtë projekt ku kjo marrëveshje është e nënshkruar dhe vulosur nga të dy palët punëdhënësi-Kiga SH.P.K si dhe punëmarrësi – Inxh Nexhmedin Gërguri, dhe po ashtu inxhinier në fjalë posedon edhe kualifikimin shkollor sipas kërkesës së FDT-së. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.”

**Pretendimi i katërt (IV) ankimor është i pa bazuar pasi që “AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional ndër të tjera ka vendosur kërkesën Kërkesa 2- Operatori Ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se mallrat e ofruara përmbushin specifikimet teknike sipas Aneksit nr.1 të Dosjes se tenderit. Për këtë kërkesë si dëshmi dokumentare e kërkuar është: Dëshmitë 2 a) Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj katalog apo broshurë me fotografi në të cilën në mënyrë të qartë specifikohen të dhënat për artikujt sipas specifikave teknike të dhëna në Aneksin 1.**

Në ofertën e dorëzuar nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë, është dorëzuar broshurë e produktit GAOKEview Mode E3. Në broshurë janë shënuar karakteristikat për modelin 75 inch, ku ndër të tjera është dhënë edhe karakteristika: “Brightness 400cd/m<sup>2</sup>”. Sipas hulumtimit të ekspertit teknik, specifikat e “Brightness 400cd/m<sup>2</sup>”, përputhet me të dhënat në broshurën e produktit Mode E3, të paraqitur në ueb faqen e prodhuesit GAOKEview, në linkun në vijim: <https://jirorwxhmkollq5m.lodycdn.com/%28E3%29+GAOKEview+Specification+of+65-86+inch+Interactive+Flat+Panel-2023-aidjpBpnKillSRikioijjoin.pdf?dp=GvUApKfKKUAU>. Andaj, sipas sqarimit të mësipërm nuk qëndron pretendimi ankimor në këtë pikë.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues dhe teknik i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Eor Group SH.P.K., Argumentimi në raportin e eksperteve është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertve. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Eor Group SH.P.K.,” sh.p.k., janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe montimi me tabela smart dhe

Teknologji Informative sipas lot I dhe lot II” me numër të prokurimit VU644-23-7254-1-2-1 lidhur me LOT I, ndërsa në ofertën e dorëzuar nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë, është dorëzuar vetëm Deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike, e cila është e nënshkruar dhe vulosur, ndërsa për pajisjet për Lot 2 nuk është dorëzuar katalogu si dëshmi për përmbushjen e kërkesës sipas pikës a).

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim dhe montimi me tabela smart dhe Teknologji Informative sipas lot I dhe lot II” me numër të prokurimit VU644-23-7254-1-2-1, për **Lot 1 Vërtetohet** ndërsa për **Lot II anulohet** dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim për LOT I ndërsa ka bazë të mjaftueshme që aktivitetin i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim për LOT II.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe jo të shoh ligji në mënyrë selektive andaj bazuar në pretendimet ankimore dhe atë që u përshkrua si më lart, psh vendosi që kjo procedure e prokurimit të kthehet në ri vlerësim me qëllim që të trajtohen në mënyrë të drejtë kërkesat, kundrejt ofertave sipas dispozitave dhe parimeve të prokurimit publik në fuqi.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimi, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Njëkohësisht e obligon Ak që gjatë rivlerësimit të ofertave të veproj konformë FDT dhe njoftimit për kontratë, si dhe të vlerësoj drejtë ofertat e operatorëve ekonomik në harmoni me nenit 7, 59.69 të LPP lidhur me nenit 40, të RRPP-së

Paneli shqyrtues sqaron se autoritet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdorën në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siq parashihet në nenin 6 të LPP-së, Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efektive transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së

ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - Eor Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: